



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MAT

KESHILLI

Adresa: Sheshi "Ahmet Zogu" Burrel ; Tel/Fax:+355 0217 22421; E-mail: bashkiamat@gmail.com

VENDIM

Nr 110 datë 20.12.2018

PËR

KËRKESË PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR E KULLOSOR PUBLIK, TË SIPËRFAQES QË DO TË PËRDORET PËR NDËRTIMI HEC .

Këshilli i Bashkisë Mat i mbledhur ne daten e mesiperme pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga specialisti i kadastrës pranë Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Pyjeve, bazuar në Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe në zbatim të kuadrit Ligji nr. 48, dt. 05.05.2016 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.9358, dt.04.05.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor", VKM Nr. 396, datë 21.06.2006 "Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore". VKM nr.1374, Datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor", të ndryshuar me Vkm.nr.592. Datë 09.10.2018, me shkronjën d)" ndryshohet me këtë përmbajtje: Miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi kullor me vendim të Këshillit Bashkiak, brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja kullorë, e cila do t'u nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi kullor.", I azhorrnuar me : Vkm nr. 435 datë 08.06.2016.

Ky komision vendosi te procedoje me Miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjore e kullor të sipërfaqëve të kërkuara nga Shoqërit e listuara mëposhtë brenda territorit administrativ të administruar nga Bashkia Mat.,

- | | |
|--------------------------------------|----------------------------|
| Shoqëria "A.R.M. – Albania" sh.p.k , | Ndërtim Heci "TRAJA I" |
| Shoqëria" A.R.M.-Albania" sh.p.k, | Ndërtim Heci "MADHESH" |
| Shoqëria" DOMA GROUP " sh.p.k, | Ndërtim Heci "VINJOLLI I" |
| Shoqëria" Nord Energy " sh.p.k, | Ndërtim Heci "MALLUNXA" |
| Shoqeria "Seka Hydropoëer" sh.p.k | Ndërtim Heci "SEKE & ZAIS" |

Keshilli pas diskutimeve me 13 vota pro dhe 0 kunder,

VENDOSI:

- I. Miratimin e heqjes nga fondi pyjor e kullisor të sipërfaqëve të kërkuara nga Shoqërite e listuara.

Nr.	Shoqëria	Emërtimi i Hec-it	Ekonomia. pyjore	Ngastra N/ngastra	Sipërfaqja që do të hiqet. Nga fondi pyjor/kullisor në ha
1	Shoqëria "A.R.M.- Albania" sh.p.k	TRAJA 1"	Ulëz - Shkopet	64/a, 71/a, 92/a	0.01, 0.02, 0.015,
	Sipërfaqja totale				0.045
2	Shoqëria "A.R.M.- Albania" sh.p.k	Madhesh	Ulëz- Shkopet	97/b, 106/c, 107/c, 108/a,	0.02, 0.02, 0.01, 0.015
	Sipërfaqja totale				0.065
3	Shoqëria "DOMA GROUP" sh.p.k	Vinjolli 1	Balgjaj	2/a, 3/a, 6/a, 4/b	0.0155, 0.0026, 0.003, 0.0364
	Sipërfaqja totale				0.0575
4	Shoqëria "Nord Energy" sh.p.k	Mallunxa	Derjan 1	122/a, 124/c	0.0155, 0.0344
	Sipërfaqja totale				0.0499
5	Shoqëria "Seka Hydropoëer" sh.p.k	"Seke & Zais"	Derjan 1 Mbasdeje	2a,3a,5a,28a 16a,16c,23a,23c, 3a,105m	0.1276
	Sipërfaqja totale				0.1276

- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Pyjeve (Zyra e Kadastrës pranë Bashkisë Mat).
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti.

SEKRETARE

Edlira PALAMANI



KRYETAR

Agim HYSA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MAT

KESHILLI

Nr. 3306 Prot.

Burrel me, 20.12.2018

Lenda : Dergim Vendimi

Drejtuar : Prefektit te Qarkut Diber

PREFEKTURES SE QARKUT DIBER

Bashkangjitur po ju dergojme Vendimin e Keshillit te Bashkise Mat,

NR. 110 Date 20.12.2018

Presim konfirmimin tuaj.

SEKRETARE E KESHILLIT

Edlira PALAMANI



CM 3306/prot
28-12-18

- sekretorës bashkë
mëqë dha zbat

28.12.2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.2016/1.prot.

Peshkopi, më 24.12.2018

Lënda: Për vendimin nr.110, datë 20.12.2018 të Këshillit të Bashkisë Mat

Drejtuar : BASHKISE MAT

B U R R E L

Këshilli I Bashkisë Mat me vendimin nr. 110, datë 20.12.2018 "Për kërkesë për heqjen nga fondi pyjor e kullosor publik, të sipërfaqes që do të përdoret për ndërtim HEC", ka vendosur të miratojë vazhdimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor e kullosor të sipërfaqeve të kërkuara nga Shoqëritë e listuara dhe të evidentuara në vendimin objekt verifikimi dhe shqyrtimi.

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, shprehet parimisht për miratimin e një vendimmarrje të tillë në kushtet e respektimit rigoroz të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e ndryshimit të regjimit juridik të pronave të pasqyruara në vendimin e lartëcituar.

Për më tepër, kujtojmë se vendimmarrje të tilla nuk mund të shmangen detyrimit ligjor të parashikuara në nenin 18 të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", për realizimin paraprakisht të dëgjësive me komunitetet përkatëse në territoret e të cilëve ndodhen sipërfaqet e ngastrave që kërkohet të hiqen nga fondi pyjor e kullosor, pasi siç dihet mos respektimi i kërkesave të tilla në mjaft raste shoqërohet me konflikte mes palëve.

Për sa sipër, vijimi i mëtejshëm i procedurave ligjore është përgjegjësi direkte administrativo-ligjore e organeve të posaçme të Bashkisë të ngarkuara për zbatimin e këtij vendimi.

P R E F E K T I

- Nêxhbedin SHEHU